

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E ENJTE 6 TETOR 2022

Duke marrë shkas edhe nga projektligji, që është paraqitur sot për diskutim dhe mbështetje me votë, për marrëveshjen për bashkëpunimin me Japoninë, me qëllim mirëmbajtjen e Muzeut Kombëtar, dua të sjell në vëmendje të publikut disa fakte që lidhen me mungesën e investimeve në objektet historike apo në zonat që përbëjnë trashëgiminë qytetare. Për sa i përket muzeut, sot ne ende nuk kemi një informacion të plotë për shkallën e ndikimit të viteve të diktaturës enveriste në sallonet e tij apo në fasadë. Si një objekt gjigantomadh, që u ngrit mbi rrënojat e një objekti, që ishte ish-Bashkia e Tiranës dhe ansambli i ministrive, i projektuar nga arkitektët italianë, muzeu është dëshmi e dukshme e simboleve të diktaturës.

Në fasadën e tij vazhdon të reklamohet një mozaik, i cili nuk ka lidhje as me artin dhe as me trashëgiminë e vërtetë me vlera historike, por, për sa kohë njëshi juaj ka vendosur që fondet të shkojnë atje, vendos ai. Zona që përfaqësoj në parlament, Shkodra është harruar për sa u përket investimeve në trashëgiminë historike, kulturore dhe qytetare. Lënia në harresë e ndërtesave historike po i kushton shtrenjtë Shkodrës. Dhjetëra ndërtesa mu në mes të qytetit, në "Gjuhador" dhe pjesë të tjera historike të Shkodrës janë në rrezik shembjeje. Sipas specialistëve dhe banorëve të zonës, banesat po shkërmoqen dalëngadalë prej braktisjes, burokracive dhe mungesës së vëmendjes dhe bashkëpunimit nga qeveria qendrore. Zona e mbrojtur e qytetit është në një moment tragjik.

Të nderuar kolegë, rreth 30 ndërtesa historike janë aktualisht në rrezik shembjeje dhe në shumë prej tyre muret duket se qëndrojnë në këmbë për inerci, ndërkohë që turistët e huaj e vendas, që e vizitojnë shpesh atë zonë, rrezikohen. Zgjidhja urgjente, e propozuar nga ekspertë të njohur, duhet të jetë: të restaurohen çatitë dhe fasadat dhe mirëmbajtja e brendshme e objekteve të bëhet nga pronarët ose objektet unike të shtetëzohen dhe të marrin funksione publike. Të nderuar qytetarë, kjo qeveri nuk mund t'i çojë fondet në fshatrat e origjinës së

Kryeministrit dhe të oborrit të tij. Shkodra është braktisur, ndërkohë që fqinjët tanë, si Mali i Zi dhe Kroacia e kanë Shkodrën në qendër të guidave të tyre turistike.

Mbi 130 monumente kulture, që shtrihen nga qarku i Shkodrës deri në Dibër, mbikëqyren vetëm nga një zyrë rajonale, e cila është katandisur me vetëm 2 punonjës zanatli, nga 40-50 që kanë qenë vite më parë në organigramën e saj. Braktisja e zonës së “Gjuhadolit, të “Dugajve të Reja” dhe e shumë objekteve të tjera historike të Shkodrës sjell dëm të madh për të ardhmen dhe formimin e brezit të ri, në raport me dëshmitë me vlerë historike dhe kombëtare. Për sa u përket ekspertëve në fushën e trashëgimisë, ata jo vetëm që nuk dëgjohen më, por nuk u merret mendimi, janë larguar nga vendet e punës dhe janë zëvendësuar me militantë e patronazhistë. A është normale?! Këtu prevalojnë vetëm kuadrot, të cilët formatohen nga shkolla sorosiane.

Në fakt, kjo shkollë prodhon vetëm gjuhën e cinizmit dhe të arrogancës. Në qeveri dhe në parlament ka njerëz, që nuk kanë lidhje me hallet e qytetarëve, aq më pak me trurin e këtij vendi, ndërkohë që modeli i korrupsionit gëlon në mënyrë dramatike nga kjo qeverisje. Pak më parë dëgjova në këtë sallë ministren, e cila tha se do të ketë një rritje të pagave të pedagogëve deri në 15%. Si kolege dhe si pedagoge, solidarizohem sot me protestën e tyre për rritjen e pagave në universitete. Është e pamundur sot që një pedagog në universitet të paguhet me 50 mijë lekë të rinj dhe të pretendojmë të formohet truri i Shqipërisë dhe të ketë edhe standarde të larta. Është shumë e vështirë, por jo e pamundur.

Ka shumë kolegë, të cilët e bëjnë, sepse, sikundër e tha dje zoti Peter Saraçi, kolegu im, i cili jep mësim në Fakultetin Ekonomik të Shkodrës, që i kthyer nga studimet në Itali, ka ardhur të kontribuojë këtu, me një rrogë modeste, duke lënë në Itali pagesën prej 1800 eurosh. Por çfarë ndodh? Fajësohen vetëm pedagogët. Gjenden argumente kundërshtie, ndërkohë që këta njerëz duhet të falënderohen, të mbështeten, të përkrahen dhe të sillen si model për të rinjtë e të rejtat e vendit. Jam e sigurt se dikush nga kjo qeveri apo nga kjo maxhorancë, e ka parë Peterin dje me syrin e cinizmit, sepse ai dhe shumë kolegë të tij kanë formim cilësor, meqenëse janë formuar në perëndim dhe jo në sallonet e Sorosit.

Falënderoj gjithë stafet akademike që u bashkuan dhe në protestë. Si ata, shumë shqiptarë janë gati për protestë. Vjedhja e ndershmëria nuk mund të ecin krah për krah me njëra-tjetrën. Ju faleminderit!